



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE  
MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 200/3 prot.

Tiranë më 13.02.2019

**REKOMANDIM**

Nr. 08, datë 13.02.2019

**PËR KONTROLLUESIN “KOMITETI PËR PAKICAT KOMBËTARE”**

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 a/1, dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Komiteti për Pakicat Kombëtare”.

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit Nr.32 datë 05.02.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit “Komiteti për Pakicat Kombëtare”, me objekt:

- Zbatimi i nenit 18 dhe 21, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Komiteti për Pakicat Kombëtare është institucion qendror, në varësi të Kryeministrit, i cili ka si synim të nxisë pjesëmarrjen e personave, që u përkasin minoriteteve, në jetën publike, si dhe të sugjerojë masa për ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të këtyre minoriteteve.

Nga verifikimi i kryer në vend, rezultoi se:

1. Kontrolluesi nuk ka vendosur politikat e privatësisë në portalin <http://www.minoritetet.gov.al>, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë këtë portal. Informacioni i publikuar në “Politikat e Privatësisë”, duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit,

të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1, të nenit 18, të ligjit nr.9887/2008: *Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale...*" dhe Vendimit nr.6/2013 *"Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale"*.

2. Kontrolluesi nuk ka *"Njoftuar"* Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të nenit 21, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*, i ndryshuar.

Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr.9887/2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*, i ndryshuar: *"...Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë"*.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i kontrollit hartoi dhe nënshkroi në prani të palëve procesverbalin e hetimit administrativ. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përfaqësuesit e kontrolluesit nuk patën kundërshtime, por kërkuan kohë për plotësimin e detyrimeve ligjore.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 18, 29, 30, 31 dhe 32 pika 1 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar,

#### **REKOMANDOJ:**

1. Kontrolluesi *"Komiteti për Pakicat Kombëtare"*, në zbatim të nenit 18, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, të informojë subjektet e të dhënave mbi përpunimin e të dhënave personale, qëllimin e përpunimit, mjetet dhe mënyrat e përpunimit, përhapjen e të dhënave etj., nëpërmjet *"Politikës së Privatësisë"* në portalin zyrtar <http://www.minoritetet.gov.al>.
2. Kontrolluesi *"Komiteti për Pakicat Kombëtare"*, në zbatim të nenit 21, të ligjit nr.9887/2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, të kryejë *"Njoftimin"* pranë Zyrës së Komisionerit.
3. Kontrolluesi *"Komiteti për Pakicat Kombëtare"*, të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga ky akt, brenda një afati 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit për masat e marra. Përmbyllja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.

4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39, të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 13.02.2019.

